Vendim nr. 313, datë 02.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 02.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (S) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **SPARTAK QIRJAQI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. (11-2023-6722) 608, datë 11.12.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës; nr. 2315, datë 22.10.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2026-278, datë 10.03.2026 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi me profesion avokat, në vitin 2020, i është drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) për të paraqitur një kallëzim penal kundër një grupi të strukturuar kriminal dhe shtetasit E.K., prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një sërë veprash penale, ndër të cilat "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (*KP*).

2. Prokuroria e Posaçme i ka kthyer përgjigje kërkuesit se për veprat penale që i adresoheshin prokurorit E.K. duhej t`i drejtohej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndërsa në lidhje me kallëzimin për grupin e strukturuar kriminal aktet ishin dërguar në Drejtorinë e Policisë Tiranë për verifikimin e aktivitetit kriminal që kishte kryer grupi në kohë të ndryshme. Kërkuesi, në datën 18.11.2020, për shkak të mosfillimit të hetimeve për çështjen e kallëzuar prej tij, i është drejtuar me ankim shtetasit O.Ç., prokuror i përgjithshëm, duke i kërkuar që të detyrojë Prokurorinë e Posaçme për fillimin e hetimeve mbi bazën e kallëzimit të tij.

3. Ndërkohë Drejtoria e Koordinimit Institucional të Prokurorisë së Përgjithshme, e drejtuar nga shtetasi S.S., ka vënë në dijeni kërkuesin se me anë të shkresës nr. 806/2 prot., datë 22.12.2020, aktet i janë dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë *(Prokuroria e Tiranës)* lidhur me hetimin për prokurorin E.K. Në vijim, në datën 14.01.2021, Prokuroria e Tiranës i ka kthyer përgjigje kërkuesit duke e vënë në dijeni se ajo nuk ka kompetencë për t`i dhënë zgjidhje ligjore problematikës së ngritur prej tij në ankim.

4. Në datën 31.05.2023 kërkuesi është paraqitur sërish në mjediset e Prokurorisë së Posaçme për të depozituar një kallëzim penal kundër shtetasit S.S., prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë, për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i KP-së, me pretendimin se kallëzimin penal të vitit 2020 e ka dërguar në mënyrë të gabuar në Prokurorinë e Tiranës dhe nuk e ka orientuar kërkuesin kallëzues për rrugën ligjore që duhej të ndiqte. Me shkresën përcjellëse nr.7876/1, datë 06.06.2023, kallëzimi i kërkuesit i është dërguar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës *(Prokuroria e Durrësit),* e cila ka regjistruar kallëzimin penal nr.1953, datë 13.06.2023 (*kallëzimi penal nr.1953/2023*) për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i KP-së.

5. Në përfundim të veprimeve verifikuese, me vendimin nr.4096/M, datë 26.06.2023, Prokuroria e Durrësit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr.1953/2023, me arsyetimin se fakti i pretenduar nga ana e kallëzuesit nuk parashikohet nga ligji si vepër penale e parashikuar nga neni 248 i KP-së, dhe nuk rezulton që është kryer ndonjë vepër tjetër penale për veprimet e kryera nga prokurorët në gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm ose të Prokurorisë së Përgjithshme, ku kërkuesi kallëzues ka depozituar kallëzimet ose ankimet përkatëse, pasi për çdo vendim pala kallëzuese ka marrë dijeni dhe është përfaqësuar vetë ose me mbrojtës ligjor të zgjedhur nga ana e tij, ku dhe ka ushtruar ankim për çdo vendimmarrje, sikurse edhe ne rastin konkret. Sipas Prokurorisë së Durrësit, nuk rezulton që prokurorët, të kenë kryer ndonjë veprim në mospërmbushje të rregullt të detyrës së tyre, por nëse palët në proces e vlerësojnë si të padrejtë vendimmarrjen e tij, ligji ka parashikuar mjete dhe forma procedurale, të cilat mund të përdoren brenda afateve ligjore për t'u ankuar në një gjykatë më të lartë, e cila do të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e veprimeve hetimore të kryera nga ana e tyre.

6. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me ankim kundër vendimit nr.4096/M, datë 26.06.2023 të Prokurorisë së Durrësit që ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr.1953/2023, duke pretenduar urdhërimin e regjistrimit të procedimit penal dhe vazhdimin e hetimeve.

7. Me vendimin nr. (11-2023-6722) 608, datë 11.12.2023, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka vendosur mospranimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë së Durrësit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. 1953, datë 13.06.2023, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, me arsyetimin se është marrë në interpretim të drejtë të ligjit material e procedural, pasi veprimet ose mosveprimet e të kallëzuarit S.S. nuk përmbajnë elemente të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Sipas asaj gjykate, mosorientimi i kallëzuesit për të ndjekur pretendimet e tij në institucione të tjera nuk mund të përbëjë apriori shpërdorim detyre, kur ligji nuk e parashikon shprehimisht një detyrim të tillë. Po kështu, gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar pretendimin e kërkuesit kallëzues se shkak për parashkrimin e disa veprave penale, për të cilat ai ka kërkuar ushtrimin e ndjekjes penale, kanë qenë veprimet ose mosveprimet e të kallëzuarit, pasi i kallëzuari nuk ka qenë prokurori i ngarkuar nga ligji për çështjet të cilat pretendohet se janë parashkruar dhe nuk ka mospërmbushje të detyrimit ligjor për hetimin e këtyre veprave penale, pasi një kompetencë e tillë ligjore i përket vetëm prokurorit të çështjes. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim dhe shtesë ankimi kërkuesi.

8. Me vendimin nr. 2315, datë 22.10.2024, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë me arsyetimin se, pasi shqyrtoi çështjen për shkaqet e ankimit të kërkuesit kallëzues, analizoi aktet e dosjes së hetimit paraprak, në raport me faktet e kallëzuara dhe shkakun mbi të cilin prokurori ka arritur në përfundimin e mosfillimit të procedimit penal në lidhje me kallëzimin e kërkuesit, pasi në bazë të nenit 290, pika 1, shkronja "ç", të Kodit të Procedurës Penale *(KPP)*, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Sipas gjykatës së apelit, veprimet e kryera nga i kallëzuari nuk janë në kundërshtim me ligjin, pasi çmohet se ato kanë qenë në përputhje me parashikimet ligjore, ku pretendimet e kërkuesit kallëzues kanë të bëjnë me formulimin dhe përmbajtjen e shkresave kthim përgjigjeje ndaj ankesave të tij lidhur me hetimin e prokurorit E.K., të cilat vlerësohet se nuk përmbajnë ndonjë veprim që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës. Për rrjedhojë, në kushtet kur palët në proces e vlerësojnë si të padrejtë vendimmarrjen e prokurorit, ligji ka parashikuar mjete dhe forma procedurale, të cilat mund të përdoren brenda afateve ligjore për t'u ankuar në një gjykatë më të lartë, e cila do të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e veprimeve hetimore të kryera nga ana e tyre. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi kallëzues.

9. Me vendimin nr. 00-2026-278, datë 10.03.2026, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se shkaqet e tij nuk janë të tilla që të cenojnë vendimmarrjen e gjykatës së apelit, si dhe nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për zhvillimin ose njësimin e praktikës gjyqësore, vendimi i ankimuar nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe, për pasojë, nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

10. Në datën 09.06.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 09.06.2026. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

11. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e *drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

11.1. *Së drejtës së aksesit,* pasi si Prokuroria e Durrësit, ashtu edhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit kallëzues.

11.2. *Parimit të paanshmërisë,* pasi anëtarët e Kolegjit Penal që kanë dhënë vendimin objekt të ankimit kushtetues individual kanë shfaqur mendimin e tyre edhe në një proces tjetër gjyqësor të përmbyllur me vendimin nr.1531, datë 24.09.2024 të po këtij kolegji që kishte për objekt kundërshtimin nga kërkuesi të vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr.K.214, datë 03.12.2023 të Prokurorisë së Posaçme për kallëzimin penal ndaj shtetasit A.K., ish-drejtues i Prokurorisë së Posaçme. Ndonëse kërkuesi ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues, për shkak të pjesëmarrjes së tyre të mëparshme dhe shfaqjes së mendimit të tyre për objektin e procedimit penal, me vendimin nr.00-2025-642, datë 26.03.2025, kërkesa u rrëzua.

11.3. *Standardit të* arsyetimit *të vendimit* gjyqësor, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimmarrjen e tij nuk ka dhënë një arsyetim ligjor mbi çka kërkuesi ka parashtruar për kriteret e regjistrimit të veprës penale dhe fillimin e hetimeve. Vendimi i Gjykatës së Lartë është jologjik dhe kontradiktor.

11.4. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi gjykimi në gjykatën e apelit është zhvilluar 10 muaj përtej afatit të përcaktuar në nenin 291, pika 5, të KPP-së, ndërsa gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar një vit e dy muaj përtej afatit të përcaktuar në nenin 435, pika 1, të po këtij kodi.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

12. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara

në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Lidhur me legjitimimin *ratione personae* të kërkuesit në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial *(shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese).* Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal që ka vendosur për ankimin e tij kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal në bazë të kallëzimit të paraqitur nga kërkuesi kallëzues. Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, kërkuesi e justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar.

14. Për sa i përket *aspektit substancial* të legjitimimit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të *(shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese).* Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra që cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

15. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor, i cili, në thelb, ka të bëjë me kundërshtimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin e tij kundër prokurorit S.S., për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i KP-së, me pretendimin se kallëzimin penal të vitit 2020 e ka dërguar në mënyrë të gabuar pranë Prokurorisë së Tiranës dhe nuk ka orientuar kërkuesin kallëzues për rrugën ligjore që duhej të ndiqte. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Durrësit ka vlerësuar se ndjekja penale nuk mund të fillojë, pasi nuk plotësohen elementet e domosdoshme të konfigurimit të veprës penale të pretenduar nga kallëzuesi, arsyetim

i cili është pranuar nga gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit, në vijim edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

16. Duke mbajtur parasysh rrethanat e mësipërme dhe pretendimet në ankimin kushtetues individual, Kolegji vëren se procesi penal ndaj shtetasit të kallëzuar ka në objekt hetimin dhe eventualisht gjykimin e veprës penale dhe të autorit të saj. Ndjekja penale ushtrohet nga prokuroria, e cila përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, që do të thotë se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit dhe është pikërisht prokuroria, organi i specializuar që ushtron ndjekjen penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit e të shoqërisë. Për këtë arsye, në raste të tilla, gjykimi kushtetues nuk mund të vihet në lëvizje nga individi që pretendon se ka pësuar dëm nga vepra penale, bazuar vetëm në pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor, pa provuar cenimin e ndonjë të drejte substanciale të lidhur drejtpërdrejt me procesin penal.

17. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kallëzimi penal ndaj personave të tretë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e kërkuesit në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të tij. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës.

18. Në kushtet kur ky kriter paraprak i pranueshmërisë së kërkesës nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve te tjera bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

19. Në përfundim, në kushtet kur një nga kriteret paraprake nuk plotësohet, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.